

Opsionet tuaja për mbledhjen e mbështetjes së fëmijëve gjatë marrjes së Temporary Assistance for Needy Families (Ndhimja e Përkohshme për Familjet në Nevojë, TANF)

Përveç rastit kur nuk është e sigurt për ju ose fëmijët tuaj, ligji ju kërkon që të ndihmoni Department of Social and Health Service (Departamentin e Shërbimit Social dhe Shëndetësor, DSHS), Division of Child Support (Divizioni i Mbështetjes së Fëmijëve, DCS), të mbledhni mbështetjen e fëmijëve kur të merrni TANF për ju dhe fëmijët tuaj. DCS ofron shërbime të plota për zbatimin e mbështetjes kur merrni TANF. Këto shërbime mund të përfshijnë DCS që zbaton detyrimin e prindit tjetër për të ofruar sigurimin shëndetësor dhe kontribuimin e pjesës së tij/saj në shpenzimet mjekësore të pasiguruara për fëmijën (fëmijët) tuaj.

Çfarë duhet të bëj për të ndihmuar DCS të mbledhë mbështetje për fëmijët?

- Emërtoni prindërit e fëmijës.
- Na jepni informacion për të ndihmuar në gjetjen e prindërve.
- Ndhmoni për të vërtetuar se cilët janë prindërit e fëmijëve.

Pse është e dobishme vendosja e atësisë dhe mbledhja e mbështetjes për fëmijët?

- Sepse mbështetja e fëmijëve mund t'ju ndihmojë të arrini vetëplotësim.
- Sepse i jep fëmijës(-ve) tënd (tuaj) një histori mjekësore familjare duke ditur se kush është prindi i tyre.
- Sepse i jep fëmijës tuaj një të drejtë ligjore për trashëgimi, sigurime shoqërore, përfitime të veteranëve dhe të drejta të tjera qeveritare.

Çfarë ndodh nëse nuk bashkëpunoj me DCS?

Nëse nuk e ndihmoni DCS-në të mbledhë mbështetje për fëmijët dhe nuk jeni miratuar për "Good Cause" (Kauzë e Mirë), granti juaj monetar mund të reduktohet me 25%.

Kur është në rregull të mos bashkëpunosh me DCS?

Nuk është nevoja të ndihmoni në mbledhjen tuaj për mbështetjen për fëmijë nëse punonjësi i Community Services Office (Zyra e Shërbimeve në Komunitet, CSO) vendos që ju keni good cause (kauzë e mire) për të mos ndihmuar. Arsyet e Good Cause (Kauzë e Mirë) janë:

- Keni frikë se ju ose fëmija (fëmijët) në kujdesin tuaj do të lëndohen seriozisht fizikisht ose emocionalisht.
- Fëmija juaj ka lindur si pasojë e një përdhunimi ose incesti.
- Ju keni filluar procedurat e birësimit ose jeni në konsulencë (deri në tre muaj) me një agjenci për vendosjen e fëmijëve për birësimin.

Çfarë duhet t'i jap punonjësit tim të CSO për të treguar se kam Good Cause (Kauzë e Mirë) për të mos ndihmuar?

- Deklaratën tuaj të nënshkruar që përshkruan frikën dhe shqetësimet tuaja
- Çdo regjistër, duke përfshirë të dhëna mjekësore, policore ose të tjera në lidhje me pretendimin tuaj të sigurisë, nëse është i disponueshëm.

A mund të mbledh ende mbështetje për fëmijët dhe të mos bashkëpunoj me DCS?

Po sepse ka dy nivele të ndryshme që mund të zgjidhni; Niveli A ose niveli B.

- Niveli A: *Nuk* do t'ju kërkohet të bashkëpunoni me DCS. Nuk do të mblidhet mbështetja e fëmijëve.
- Niveli B: *Nuk* do t'ju kërkohet të bashkëpunoni me DCS, por mbështetja për fëmijët do të mblidhet dhe adresa juaj mbetet e mbrojtur.

Çfarë duhet të bëj nëse nuk është më e sigurt që DCS të mbledhë mbështetje për fëmijët?

- Kontaktoni menjëherë punonjësin tuaj CSO dhe nëpunësin tuaj për mbështetjen e fëmijëve në DCS. Tregojuni të dyve për situatën tuaj të re.
- Kërkoni Good Cause (Kauzë e Mirë) duke plotësuar këtë formular.
- Nëse aktualisht keni Nivelin B të Good Cause (Kauzë e Mirë), konsideroni të kaloni në nivelin A.
- Kërkoni një referim nga avokati i dhunës në familje në vend ose në komunitet.

Po sikur të mos pajtohem me vendimin e CSO për Good Cause (Kauzë e Mirë)?

Keni të drejtë të kërkoni një seancë dëgjimore administrative për vendimin e Good Cause (Kauzë e Mirë). Një seancë dëgjimore administrative është një rishikim i vendimit të Good Cause (Kauzë e Mirë). Shihni "Administrative Hearing Process" ("Proçesi i Seancës Administrative") në faqen tjetër për më shumë informacion mbi seancën dëgjimore administrative.

Nëse keni ndonjë pyetje në lidhje me ndihmën me mbledhjen e mbështetjes për fëmijët, pyesni përpara se të nënshkruani këtë formular. Shënoni vetëm një nga deklaratat e mëposhtme.

- Besoj se është e sigurt për mua dhe fëmijët e mi që DCS të mbledhë mbështetjen për fëmijët. E kuptoj që duhet të ndihmoj DCS-në të mbledhë mbështetjen për fëmijët dhe nëse nuk e bëj, granti im monetar do të reduktohet me 25%.
- Kam një arsye të mirë për të mos ndihmuar. Ju lutemi përshkruani arsyen tuaj duke përshkruar frikërat dhe shqetësimet tuaja në faqen tjetër.

Ju lutemi, përshkruani arsyen tuaj për të kërkuar Good Cause (Kauzë e Mirë) duke përshkruar frikërat dhe shqetësimet tuaja.

Betohem se deklarata e mësipërme është e vërtetë.

EMRI KLIENTIT (I SHKRUAR)	NUMRI I IDENTIFIKIMIT TË KLIENTIT
NËNSHKRIMI I KLIENTIT	DATA
I kam dhënë klientit një kopje të këtij formulari.	
NËNSHKRIMI I PUNONJËSIT	DATA
EMRI I NON-CUSTODIAL PARENT (PRINDIT JO KUJDESTARË)	NUMRI I IDENTIFIKIMIT TË KLIENTIT
EMRI FËMIJËS	NUMRI I IDENTIFIKIMIT TË KLIENTIT
EMRI FËMIJËS	NUMRI I IDENTIFIKIMIT TË KLIENTIT
EMRI FËMIJËS	NUMRI I IDENTIFIKIMIT TË KLIENTIT

Procesi i seancës administrative

1. Mund ti telefononi Community Service Office (Zyra Lokale e Shërbimit në Komunitet) për të kërkuar një rishikim të çështjes suaj.
2. Mund ti telefononi Community Service Office (Zyra Lokale e Shërbimit në Komunitet) ose t'i shkruani Office of Administrative Hearings (Zyra e Seancave Administrative), PO Box 42489, Olympia, WA 98504-2489 brenda 90 ditëve për të kërkuar një seancë dëgjimore. Nëse kërkon një seancë dëgjimore, DCS nuk do të fillojë të punojë për çështjen tuaj derisa vendimi i seancës të jetë përfundimtar.

Në seancë mund t'ju përfaqësojë një avokat ose një person tjetër që ju zgjidhni, ose mund të përfaqësoni veten.

A mund të marr këshilla ose përfaqësim ligjor?

Mund të telefononi linjën e shërbimeve ligjore mbarëkombëtare në 1-888-201-1014.